



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dërguar / Punë / Received / Delivered	08.08.2022	2022	viti / god / year
Organ / Njësia / Org / Jednica / Org / Unit	to / për / për / a / për / a /	nr. / nr. / nr. /	Sasia / Kolicina / Quantity
SHKRBIMIN	4592/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.577/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtar, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.577/2022 të datës 28.06.2022 të ankuesit me adresë banimi:

kundër Njoftimit të datës 20.06.2022 të Komunës së Hanit të Elezit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa A.nr.577/2022 e datës 28.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

Arsyetim

Komuna e hanit të Elezit më datë 29.04.2022 ka shpallur konkursin për pozitën “Specialistë të Arkitekturës”-“Zyrtar për planifikim dhe zhvillim”, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi pakënaqur me Njoftimin e datës 20.06.2022 të Njesisë së Personelit lidhur me Rezultatit Përfundimtar i verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankuesi i pakënaqur i pakënaqur me Njoftimin e datës 20.06.2022 të Njesisë së Personelit të Komunës së Hanit të Elezit, ka parashtruar ankesë me datë 28.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli: 3771/2022 me pretendimet ankimore që procedura e rekrutimit për pozitën Specialistë të Arkitekturës”-“Zyrtar për planifikim dhe zhvillim” të rishikohet dhe kandidatja M.S-L të hiqet nga lista pasi që të njëjtës i është pranuar dokumentacioni pas afatit të paraparë sipas konkursit dhe në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 1, 3, 4 dhe 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik,



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 01.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Hanit të Elezit, ndërsa Hanit të Elezit me datë 13.07.2022 ka dërguar përgjigje në ankesë e cila në Këshill është regjistruar me numër prot:4062/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 28.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 29.04.2022; Njoftimin e datës 10.06.2022 lëshuar nga Zyra e Personelit; Njoftimin e datës 20.06.2022 lëshuar nga Zyra e Personelit; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2022; Përgjigja në ankesë e datës 13.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 16.06.2022 drejtuar kandidatës M.S-L nga Zyra e Personelit; Ankesën e datës 14.06.2022 të parashtruar nga kandidatja M.S-L me e-mailin e bashkangjitur të datës 14.06.2022; Çertifikatën e Gjykatës Themelore në Ferizaj dega Kaçanik të datës 10.06.2022; Njoftimin e datës 10.06.2022; Aplikacionin e kandidatës të datës me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e ankuesit të datës 27.05.2022 me dokumentacionin e bashkangjitur

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe lejueshmërisë së shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me procedurën e rekrutimit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”) . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet”.*

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi ka qenë pjesë e procedurës së rekrutimit për pozitën *“Specialistë të Arkitekturës”-“Zyrtar për planifikim dhe zhvillim”* të shpallur nga Komuna e Hanit të Elezit, ndërsa i njëjti i pakënaqur me Njoftimin e datës 20.06.2022 të Njesisë së Personelit të Komunës së Hanit të Elezit, ka parashtruar ankesë me datë 28.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj në mbështetje të nenit 31 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“3. Në rastin e pakënaqësisë ndaj procedurës apo rezultatit të konkurimit, pavarësisht nga faza me të cilin kandidati është i pakënaqur, ankesa parashtrohet ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. 4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.1 kandidati i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15 të kësaj rregulloreje; dhe 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje”*, Kolegji ka konstatuar se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 28.06.2022 është e palejueshme pasi që i njëjti nuk ka parashtruar ankesë kundër aktit përfundimtar të procedurës së rekrutimit, rrjedhimisht sipas vlerësimit të Kolegjit në këtë fazë të rekrutimit nuk është e lejuar ankesën në Këshill në kuptim të nenit 31 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës i pasqyruar si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa këshilla juridike e dhënë mbi të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike në njoftimin e datës 20.06.2022 është dhënë gabimisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës hanit të Elezit.

Pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës dhe pasqyrimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshilli njëzëri konstaton se ankesa e ankuesit është e palejueshme në këtë fazë, ngase verifikimi paraprak nuk llogaritet akt përfundimtar i përfundimit të procedurës së rekrutimit në kuptim të nenit 31 paragrafi 3 të

Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe peshimit të secilës provë në procedurë të shqyrtimit të ankesës së ankuesit në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe" ankesa e ankuesit vlerësohet të jetë e palejuar në këtë fazë të procedurës së rekrutimit

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.577/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Hanit të Elezit;
- Arkivit të KPMSHCK-së